

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/06/07

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-71121-05-31-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Bashkia Gjirokaster

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1962663

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Kancelari

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/06/12

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/06/12

Numri i njoftimit

Kodi CPV

71121

30192124-630192130-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gjirokaster, ka publikuar në faqen e APP-së në datë 01.06.2023, ora 1000, tenderin me objekt “Kancelari”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 12.06.2023, ora 1000.

Duke qenë se disa prej këtyre kërkesave i gjykojmë në shkelje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, po paraqesim këtë ankesë.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

? Ne shtojcën 6 “Formulari I sasise dhe grafiku i levimit” është percaktuar se afati levimit të mallit për këtë procedurë do të jetë 15 dite:

Ju sjellim në vëmendje se për këtë procedurë, prokurohen artikuj, në sasi të mëdha. Ajo që kërkon AK është që të shpërndahen 185 artikuj të ndryshëm në 11 njësi levrimi, kerkese kjo e ekzagjeruar dhe në tejkalim të dispozitave ligjore. Afati prej 15 ditësh nuk është i mjaftueshëm dhe nuk është në përputhje me natyrën e kontratës.

Artikujt objekt i kësaj kontrate, nuk janë me baze prodhimi vendas, por importohen nga firmat prodhuese ndërkombëtare dhe kalojnë një sërë procedurash, të cilat në asnjë rast, nuk përmbillen brenda këtij afati.

Kerkesa juaj për levrim brenda 15 ditësh, diskriminon të gjithë OE të interesuar të marrin pjesë në këtë procedurë, por që nuk mund t'i mbajnë gjendje këto produkte, por i porosisin në momentin e shpalljes së fituesit përfundimtar. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për problematikat dhe afatet e procedurave të transportit, të zhdoganimit etj, të cilat gjithnjë zgjasin shumë, aq më tepër që brenda këtij afati duhet të jete përbyllur edhe levrimi në këtë institucion. Me këtë kerkese, AK favorizon dhe drejton dhenien e kontratës, vetëm në OE që i ka gjendje mallrat objekt prokurimi, duke paracaktuar fituesin. Gjithsesi fakti që shpërndarja bëhet në 11 institucione të ndryshme, e bën të pamundur levrimin brenda 15 ditëve.

Vlen të përmendim, se disa here, AK, ia kalojnë të gjithë barrën e emergjencave për furnizim, OE të interesuar për të fituar kontratën, ndërkohë që kanë të gjithë mundësitë të bëjnë planifikimet e tyre në kohë, që të mos gjenden përballë “situatave emergjente”.

Ju lutemi, mirekuptoni domosdoshmerinë e OE për një afat levrimi minimalisht prej 30 ditësh dhe modifikoni këtë kriter.

? Në specifikimet teknike, për artikullin 13 AK ka kërkuar:

13 Bojë vule Bojë për vulë ngjyrë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave. Bojë ekologjiksht e pastër dhe rezistente. Boja vjen në paketim 30ml. Kuti metalike

Nen dijenine tone, boja e vules eshte e ambalazhuar ne shishe plastike. Kerkesa qe kutia te jete metalike eshte e egzagjeruar, per sa kohe qe materiali i kutise nuk ndikon ne funksionalitetin e produktit. Per kete arsye kerkojme qe te hiqet togfjaleshi 'Kuti metalike'.

? Ne specifikimet teknike, per artikullin 23 AK ka kerkuar:

23 Dosje kartoni kuti arkive me lidhese Të ketë përmasa 410x280x170 mm (5% marzh gabimi), material kartoni i fortë. Me kapak, karton i trashë.

Per kete artikull doni Dosje kartoni kuti arkive apo Dosje me lidhese ?

Jemi te paqarte per kerkesen tuaj , pasi keto jane dy produkte te ndryshme. Percaktoni qarte llojin e dosjes.

? Per artikullin 25 AK ka kerkuar:

25 Dosje me llastik 25*34.5 cm

Permasat kaq fikse , te detajuara deri ne milimentra kufizojne konkurrencen. Kerkojme qe te vendosni nje diapazon te permasave, ku te jete minimalisht ? 2cm.

? Per artikullin 29 AK ka kerkuar:

29 Dosje te medha me butona A4

Percaktoni sa te gjera duhet te jene dosjet . Fillojne nga 6cm deri ne 15cm.

? Per artikullin 50 AK ka kerkuar:

50 Gome 6*2*1.5 e bardhe

Permasat kaq fikse , te detajuara deri ne milimentra kufizojne konkurrencen. Kerkojme qe te vendosni nje diapazon te permasave.

? Per artikullin Nr.57 ne specifikimet teknike AK ka kerkuar:

57 Kapese me vesh te vegjel 20mm Kapese me veshë 19 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.

Standarti i kesaj permase tek kapset me veshe eshte 19mm (sikurse e keni shkruar tek specifikimet teknike) dhe jo 20 mm. Duhet te saktesohet emertimi i artikullit.

? Per artikullin Nr.60 AK ka kerkuar ne specifikimet teknike:

60 kapese me vesh te medhenj 50mm Kapese me veshë 51 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve

Standarti i kesaj permase tek kapset me veshe eshte 51mm (sikurse e keni shkruar tek specifikimet

teknike) dhe jo 50 mm. Duhet te saktësohet emertimi i artikullit.

? Per artikullin Nr.78 AK ka kerkuar:

78 Leter e tejdkushme (kalk) A4

Sa fije kalk duhet te kete nje pako?

? Per artikullin Nr.82 AK ka kerkuar:

82 Liber evidence stervitjeje A5 X2/2

Nuk jemi te qarte lidhur me kerkesen X2/2 . Pershkruani qarte specifikimet teknike te artikullit.

? Per artikullin Nr.92 AK ka kerkuar:

92 Liber Raport nderhyrje A4 X 2/2x50 flete

Nuk jemi te qarte lidhur me kerkesen A4 X 2/2x50 flete . Pershkruani qarte specifikimet teknike te artikullit.

? Per artikujt Nr.106 dhe Nr.107 AK ka kerkuar:

106 Marker I kuq Maxx 290

107 Marker I zi Maxx 290

Maxx 290 eshte nje produkt specifik i markes Schneider, sikurse mund ta shikoni edhe tek fotoja me poshte:

Ju kujtojme se kjo kerkese eshte ne kundeshti me Nenin 36 LPP162/2020 , pika 4, percakton :

Në specififikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Ne keto kushte kerkojme qe te hiqet kerkesa qe markeri te jete Maxx 290 , per sa kohe qe LPP nuk e lejon kete gje.

? Per artikullin Nr.153 ne specififikimet teknike ,AK ka kerkuar:

153 Tampon vule Ngjyra blu të jetë në kuti metalike, përmasa minimumi 8x12cm.

Tamponet e vules mund te jene te ambalazhuara ne kuti metalike ose plastike. Per sa kohe qe kutia nuk ndikon ne funksionalitetin e produktit, kerkojme qe te hiqet kerkesa qe kutia te jete metalike.

? Per artikullin Nr.160 AK ka kerkuar:

160 Tela per mak kapese 24/6 ngjyre bronx

Kerkojme qe te hiqet kerkesa qe telat te jene ngjyre bronx, pasi ngjyra nuk ndikon ne funksionalitetin e produktit, perkundrazi, kufizon konkurrencen.

? Per artikujt Nr.174,175,176,177 AK ka kerkuar:

174 Vule per Kinema Gjirokaster

175 Vule per biblioteken "A Meksi

176 Vule per biblioteken "T Gjokuta"

177 Vule per teatrin Zihni Sako

Mqs kerkoni nje vule te personalizuar, duhet te publikoni modelin e vules dhe permasat e peraferta te saj.

Specifikimet e mesiperme, jane kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojne te drejten e OE te interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. Keto kritere nuk e justifikojne qellimin per te cilin jane vendosur, pasi nuk garantojne cilesine dhe standartin e larte, per keto produkte.. AK, ne hartimin e specifikimeve teknike, krahas pershkrimit te sakte te nevojave, duhet te kene ne vemendje faktin, qe specifikimet teknike, duhen bere ne menyre gjithperfshirese, duke krijuar kushte per konkurrim te paaneshem e te hapur, ndermjet te gjithë kandidatëve ofertues, duke pershkruar sakte dhe plote karakteristikat e mallrave, ne perputhje me objektin e kontrates. Neni 36, pika 2 i LPP nr 162/2020, percakton qarte se:

“Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te barabarte per te gjithë kandidatët ofertues dhe te mos sherbejne si pengese per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik.”

Ne respekt te ketij parimi, specifikimet teknike, ne asnje rast, nuk duhet te perjashtojne apo diskriminojne operatorët ekonomike ofertues. Ato duhet te shmangin cdo forme diskriminimi, qofte te dukshme apo te fshehta, te cilat kane te njejtin efekt. Ato nuk duhet te hartohen ne nje menyre te tille, qe te cojne drejt nje produkti te caktuar, qe ofrohet nga nje operator i vetem ekonomik, apo nga nje prodhues i vetem.

Kerkojme modifikimin e tyre, hapjen e diapazonit, ne menyre qe te nxitet konkurrenca.

Gjithashtu AK me specifikimet teknike dhe artikujt qe po prokuron, te cilat jane objekt ankimi eshte ne kundeshiti me ate qe ka shprehur vet ne specifikimet teknike sa me poshte:

“Pershkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste

të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent". Me poshte, po permendim disa raste ku edhe KPP ka dhene vendime, duke mbeshtetur arsyetimet e mesiperme.

Sa me lart, per te cilat kerkojme modifikim ju sjellim ne vemendje qendrimin qe mban KPP per specifikimet teknike te ekzagjeruara, percaktuar ne Vendimin Nr. 124/2022:

“III.2.8 KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Referuar objektit dhe volumit të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të krijojë bindjen se operatorët ekonomikë kanë aftësi të ofrojnë produktet objekt-prokurimi, të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, por gjithmonë duke përcaktuar kritere në përputhje me objektin e kontratës, në përpjesëtim me volumin e saj, si dhe jo kufizuese apo diskriminuese. Komisioni gjykon, se është e nevojshme që operatorët ekonomikë të ofrojnë produktet objekt-prokurimi por jo domosdoshmërisht në mënyrë kufizuese, pasi në fushën e veprimtarisë objekt-prokurimi, ekzistojnë edhe artikuj të tjerë ekuivalent, të cilët kanë funksionalitet të njëjtë. Gjithashtu, Komisioni gjykon, se edhe kërkesa për disponimin e artikujve me këto specifikime është e ekzagjeruar. Autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, ndaj çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti tij/saj.”. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të zbatojë me përpikëri dispozitën e mesiperme të LPP-se në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit duke shtuar termin ekuivalent për zërat e sipërmendur.”

-Ne qendrimin qe ka mbajtur KPP me Vendimin Nr. 255 /2022, shprehet:

“Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” III.1.5. KPP gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. ?..

Ju sjellim ne vemendje Rekomandimin mbi hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit punera, mallra, shërbime nga APP të datës 24.12.2021, ku APP përcakton në pikën 16 se

per procedurat e hapura te thjeshtuara, si procedura ne fjale, AK duhet te percaktojne kritere te thjeshtuara pranimi:

16. Se fundmi, sjellim ne vemendje te autoriteteve/enteve kontraktore se ne rastin e procedurave te hapura te thjeshtuara, te percaktojne kritere sa me te thjeshta pranimi, per operatoret ekonomike, me qellim nxitjen e konkuresces dhe pjesemarrjes se biznesit te vogel dhe te mesem, duke mbajtur ne vemendje percaktimet e nenit 55, pika 4, te RRPP, ku parashikohet:

Ne kete lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet te mbajne ne konsiderate te percaktoine kritere te thjeshtuara pranimi, me qellim nxitjen e pjesemarrjes se biznesit te vogel dhe te mesem.”

Po bejme kete ankimim, me bindjen se, modifikimi i ketyre kritereve, nuk do te cenoje aspak cilesine e produktit , funksionalitetin e tij dhe do te plotesoje me se miri, te gjitha nevojat e AK. Po paraqesim kete ankesë mbështetur në LPP, Udhëzimet e APP, duke kërkuar modifikim të disa kërkesave të tenderit.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

aarapi@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani